

**AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“ REKOPOL-AL ” SHPK**

Në Tiranë, sot më datë 10.05. 2022, ne të poshtëshënuarit:

Tahir Osmani i datëlindjes 01.10.1956, lindur në Mat dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal F61001210C, me cilësinë e “ ortakut themelues ” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “REKOPOL-AL” shpk.

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “REKOPOL-AL” SHPK, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3
Selia e Shoqërisë

Shoqëria e ka seline në adresë: Tirane, Dajt Lanabregas, Rruga Hamdi Gjuzi, Magazina Nr.1, Kati I, Numer 1040.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë se saj :

- Mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve rrugore apo pjeseve të tyre (katalizatore) të dala jashtë përdorimit apo të braktisura, transport, tregëtim, import-eksport, brenda dhe jashtë vendit
- Mbledhje, depozitim, shkatërrim të (kompjutrave) të dala jashtë përdorimit apo të braktisur, transport, tregëtim (import-eksport) brenda e jashtë vendit.
- Grumbullim, transport, tregëtim, import-eksport, brenda e jashtë vendit të Bimeve Medicinale.
- Gjithashtu Shoqëria, mund të kryej cdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj, përfshirë dhe konsulencës, ofrim të shërbimeve të tregëtimit të materialeve brenda dhe jashtë vendit (Import -Eksport) të këtyre materialeve apo mallrave.
- Për të arritur objektivin e saj, mund të realizojë drejtpërdrejt apo në mënyrë tërthore cdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera Shqiptare apo të huaja , si dhe të hyjë në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë , private ose publike, vendas apo të huaj.

- Shoqëria mund të ushtroj çfardollosj aktiviteti tjetër të pa përcaktuar në këtë akt , të çfardollosj natyrë qofte, por që nuk është në kundërshtim me legjislacionin Shqipëtar në fuqi pa asnjë kufizim.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat, duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 1 kuotë, dhe zotërohet nga ortakut i vetëm z. Tahir Osmani me 1 kuotë me vlerë të përgjithëshme 100,000 leke , e cila përben 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Dërdhja e kapitalit do të kryhet menjëher pas regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregëtar , gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Transferimi i kuotave të kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me shitje, dhurim, trashëgimi ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligjësllacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shit-blerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Organi vendimarrës i Shoqërisë "REKOPOL-AL" Shpk, janë:

- Asamblea e Përgjithëshme;
- Administratori.

Neni 9
Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i late vendimmarres i Shoqerise dhe merr vendime kur eshte mbledhur rregullisht. Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, ne perputhje me ligjin dhe me kete Statut jane te detyrueshme per te gjithë ortaket perfshire ata qe mungojne.

Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji per shoqerite tregtare, ligje te tjera, dhe sa here eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mbahet ne seline e Shoqerise ose ne çdo vend tjeter te shenuar ne njoftimin per mbledhje. Njoftimi per mbledhje i dergohet me shkrim te gjithë ortakeve Jo me vonë se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme mund te kerkohet edhe nga ortaku ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te zakonshme e jashtezakonshme.

Neni 10
Administrimi i shoqerise

Administrimi i shoqerise behet nga Administratori :

Administrator i shoqërisë është:

- Tahir Osmani, i datëlindjes 01.10.1956, lindur në Mat dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal F61001210C, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripëritje.

Neni 11
Kompetencat

Administratori ka kompetencat dhe detyrat e meposhtrene:

- a) Mbikeqyr dhe zbaton politiken e biznesit te Shoqerise;
- b) Perfaqeson Shoqerine;
- c) Kujdeset qe Shoqeria te zbatoje ligjet dhe standartet e mbajtjes se Ilogarive;
- d) Pergatit dhe nenshkruan bilancin dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e titimeve ja paraqet Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) Siguron qe deklaralat e lliogarive vjetore si dhe raporti i ecurise se biznesit dhe çdo dekiarim tjeter i detyrueshem sipas ligjit ose statutit, jane bere sic duhet;
- f) siguron qe auditimi i librave dhe i te dhenave kryhet te pakien nje here ne vit nga eksperte kontabel te çertifikuar dhe raporti i Ilogaritaveve publike te çertifikuar t'i vihet ne dispozicion Asambiese se Pergjithshme;
- g) Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise;

- Administratori mund të ndermarre apo të kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakëve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

- Përveç sa më sipër, Administratori ka gjithashtu ;

a. të gjitha të drejtat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, të gjitha kompetencat dhe të drejtat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua njeh shprehimisht ortakëve.

b. Administratori, bazuar në një vendim të asamblesë së ortakëve, mund të emerojë drejtore, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.

c. Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për hogan të shoqërisë, pa marrë me parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.

Neni 12

Shpërblimi i Administratorit

Shpërblimi i administratorit të shoqërisë do të përcaktohet nga ortakët.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblesë së ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Prishja dhe Likuidimi i shoqërisë

Në rastin e prishjes e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (të ndryshuar).

Shoqëria priset:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007. "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Ne rastin e pikës b) Asambleja e Ortakëve merr vendim në të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerrë prej saj emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër ”.

Neni 16

Te drejtat dhe detyrimet e Likuiduesit

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Neni 17

Riorganizimi (bashkimi, ndarja, shndërrimi

Riorganizimi i shoqërisë (bashkim, ndarje, shndërrim) do të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 18

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë akt – themelimi e statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 20

Dispozita përfundimtare

Ky, Akt-Themelimi e Statut u redaktua në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lire nga ortaku themelues.

ORTAK THEMELUES

Tahir Osmanj



Tiranë, më datë 10.05.2022